

KUSHTET E PERGJITHESHME TE SIGURIMIT TE PARAVE NE KASAFORTE

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kushtet e Përgjithshme të kontratës për Sigurimin e Parave në Kasafortë (CIS), këtu më poshtë do të quhen shkurtimisht "Kushtet e Sigurimit".

Instituti i Sigurimeve, këtu më poshtë do të quhet "Siguruesi".

Personi fizik ose juridik, interesi pasuror i të cilit do të mbulohet sipas këtyre Kushteve të Sigurimit për Sigurimin e Parave në Udhëtim, këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "I Siguruari".

Kontrata për Sigurimin e Parave në Kasafortë, e lidhur midis Siguruesit dhe të Siguarit, këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "Polica e Sigurimit".

PASURIA E SIGURUAR

2. Kartmonedha në formën e valutave të ndryshme, përfshirë kartmonedhën shqiptare, deri në kufirin e përmendur në Policën e Sigurimit.

Pasuria e siguruar mund të jetë në pronësi të të Siguarit ose e mbajtur nga i Siguruari në çdo formë që e bën të Siguarin përgjegjës për humbjen e saj.

RREZIQET E SIGURIMIT

3. Siguruesi dëmshpërblen të Siguarin për humbjen ose dëmtimin e pasurisë së siguruar si rrjedhojë e vjedhjes përmes hyrjes dhe/ose daljes me dhunë dhe/ose forcërisht nga njësi e siguruar.

Pasuria mbulohet në sigurim ndërsa ndodhet në kasafortë dhe/ose sportel/arkë.

PËRJASHTIME

4. Sigurimi CIS nuk mbulon dëmet që shkaktohen drejtpërdrejt apo indirekt prej:

- a. zhdukjeve misterioze;
- b. mashtrimit dhe jobesueshmërisë së punonjësve;

5. Ky sigurim nuk mbulon dëmet që shkaktohen drejtpërdrejt apo indirekt prej:

- a. grevave, kryengritjeve, trazirave dhe turbullirave civile.
- b. luftes, pushtimit, invazionit, veprimeve të armiqve të huaj, veprimeve luftarake (pavarësisht nëse është shpallur luftë ose jo), luftes civile, rebelimeve, revolucionit, kryengritjeve, fuqive ushtarake apo pushtuese, konfiskimeve ose shtetëzimeve ose rekuizimeve ose shkatërrimeve të pasurisë nga apo në baze të urdherave të çdo qeverie oqë autoriteti publik ose lokal.

6. Ky sigurim nuk do të mbulojë dëmtimin/humbjen, përgjegjësinë apo shpenzimet e shkaktuara drejtpërdrejt ose indirekt nga ose që rrjedhin prej:

- a. rrezatimit jonizues ose ndotjes radioaktive nga lende berthamore ose rezerve berthamore ose nga shperthimi i lendeve berthamore;
- b. lendeve radioaktive, helmuese, shperthyese ose lende të tjera të rrezikshme apo ndotese të instalimeve berthamore, reaktoreve berthamore apo njesive të tjera berthamore ose elementeve berthamore;
- c. çdo arme luftë që shfrytëzon zberthimin dhe/ose bashkimin berthamor apo të ngjashme me to.

KËRKESA PËR DËMSHPËRBLIM

31. I Siguruari, për marrjen e dëmshpërblimit, i paraqet Siguruesit kërkesë me shkrim sipas formularit të furnizuar nga Siguruesi.

32. Siguruesi paguan dëmshpërblimin pasi ka marrë akt-ekspertimin përfundimtar dhe vetëm në qoftë se i paraqitet kërkesa me shkrim nga i Siguruari.

DËMSHPËRBLIMI

33. Siguruesi paguan ose refuzon pagimin e dëmshpërblimit brenda 30 ditëve nga ajo e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim.

Fillimi i afatit pezullohet për atë kohë sa dëmshpërblimi nuk mund të paguhet ose përcaktohet për shkak të të metave që ka i Siguruari.

34. Siguruesi mund të shtyjë pagesën e dëmshpërblimit:

a. për atë kohë sa ekzistojnë dyshimet mbi të drejtën e të Siguarit për të marrë pagesën;

b. në qoftë se është filluar çështja penale lidhur me ngjarjen e sigurimit ndaj të Siguarit ose njerit prej punonjësve të tij deri në përfundimin e një procedure të tillë.

35. Siguruesi përgjigjet për dëmet që vërtetohen gjatë periudhës së mbulimit në sigurim, por shuma e përgjithshme e dëmshpërblimeve nuk mund të jetë më e lartë se shuma e siguruar e treguar në Policën e Sigurimit.

36. Ky sigurim nuk do të dëmshpërblejë dëme për të cilat i Siguruari përfiton dëmshpërblim nën kontrata të tjera.

Bën përjashtim pjesa e dëmit që tejkalon shumën që do të ishte mbuluar nën kontratat e tjera në rastin kur Polica e përcaktuar nga këto Kushte Sigurimi të mos ishte në fuqi.

37. Në rast pagese dëmi sipas kësaj Police, Siguruesi do të ketë të drejtë të përfitojë të drejtën e të Siguarit për të kërkuar kthimin e të drejtave pasurore ose çdo të drejtë tjetër legale ndaj çdo personi ose organizate.

I Siguruari do të veprojë me të gjitha mënyrat e duhura për të siguruar këto të drejta.

I Siguruari nuk do të bëjë asnjë veprim për të paragjykuar këto të drejta.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

41. Për çdo mosmarrëveshje që nuk zgjidhet me mirëkuptim, palët do t'i drejtohen Gjykatës së vendit ku është lëshuar Polica e Sigurimit.